



A.nr.693/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.693/2026, të datës 23.06.2026, të parashtruar nga ankuesja A.A-B, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Fis Murati dhe Avokat Shkëlzen Feka, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*transferim i përhershëm*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprobuhet si e bazuar ankesa me numër A.nr.693/2026, e datës 23.06.2026, e parashtruar nga ankuesja A.A-B.

II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokolli 14-020/04-77518/26, i datës 29.05.2026, i Kryetarit të Kryeqytetit (Komunës së Prishtinës).

III. Obligohet Kryetari i Kryeqytetit (Komunës së Prishtinës), që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, ankuesen ta kthejë në vendin e saj të punës sipas aktit të emërimit Nr.01-112-904, të datës 16.11.2024, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile A.A-B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja) më datë 23.06.2026, përmes përfaqësuesit të saj, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 14-020/04-77518/26, të datës 29.05.2026, të Kryetarit të Kryeqytetit (Komunës së Prishtinës), për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 29.06.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo

e fundit, më datë 15.07.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2829/2026 të datës 23.06.2026 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 15.06.2026; Kopjen e ID-së së ankuses; Akt Emërimit e datës 16.11.2024; Vendimin me numër protokolli 14-020/04-77518/26, të datës 29.05.2026, të Kryetarit të Kryeqytetit (Komunës së Prishtinës); Vendimin me numër protokolli 14-117/01-0073262/25, të datës 25.05.2025 për transferim të përkohshëm të ankuses; Vendimin me numër protokolli 14-112/01-02-0175634/25, të datës 19.11.2025 për transferim të përkohshëm të ankuses; Raportin janar-tetor 2024 të ankuses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.06.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 15.07.2026; Akt Emërimit e datës 01.06.2026; Akt Emërimit e datës 17.06.2025; Emailin e datës 16.04.2025 nga ankuesja për F.D dhe V.R; Emailin e datës 15.04.2025 nga ankuesja për V.K, A.K, F.D, V.R; Emailin e datës 14.04.2025 nga V.K për ankuesen; Emailin e datës 22.04.2025 nga L.S për ankuesen; Emailin e datës 22.04.2025 nga F.D për L.S; Emailin nga V.R për G.R lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2023, 2024 dhe 2025; Emailin e datës 01.04.2025 nga V.K për ankuesen dhe Y.R; Emailin e datës 17.03.2025 nga V.K për ankuesen Vendimin e datës 22.05.2025 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës; Vërejtjen me shkrim përmes emailit të datës 01.04.2025, 02.04.2025 dhe 14.04.2025 për ankuesen; Vërejtjen me shkrim të datës 03.06.2025; Emailin e datës 15.04.2025 nga ankuesja për V.K; Komunikimin përmes telefonit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuses **është e bazuar, sepse:**

Gjendja e Çështjes

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se:

- Ankuesja sipas Akt Emërimit me Nr.01-112-904, të datës 16.11.2024, mban pozitën *Udhëheqëse e Sektorit për Gjeodezi* në Komunën e Prishtinës.
- Ankuesja fillimisht sipas Vendimit me Nr.14-117/01-0073262/25 të datës 26.05.2025, ishte transferuar përkohësisht nga pozita Udhëheqëse e Sektorit të Gjeodezisë në pozitën Udhëheqëse e Sektorit të Logjistikës për periudhën nga data 02.06.2025 deri më datë 01.12.2025, ndërsa, sipas Vendimit me Nr. 14112/0102-0175634/25 të datës 19.11.2025, sërish ka qenë e transferuar përkohësisht nga pozita Udhëheqëse e Sektorit të Gjeodezisë në pozitën Udhëheqëse e Sektorit të Logjistikës për periudhën nga data 02.12.2025 deri më datë 01.06.2026.
- Më Vendimin me numër protokolli 14-020/04-77518/26, të datës 29.05.2026, të Kryetarit të Kryeqytetit (Komunës së Prishtinës), ankuesja është transferuar në mënyrë të përhershme për shkak të pamjaftueshmërisë profesionale nga pozita Udhëheqëse e Sektorit të Gjeodezisë në pozitën Udhëheqëse e Sektorit të Logjistikës.

Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me numër protokolli 14-020/04-77518/26, të datës 29.05.2026, të Kryetarit të Kryeqytetit (Komunës së Prishtinës), me pretendimet se vendimi i kontestuar është përfshirë në shkelje ligjore gjegjësisht i njëjti është në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, nenin

48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Arsyeimi i vendimit të kontestuar është kontradiktor sepse thuhet që në kohën kur ankuesja ka qenë e transferuar në pozitë tjetër janë proceduar 3000 kërkesa dhe ka ndikuar në performancën e drejtorisë, ndërsa vendimi i kontestuar nuk mbështetjet në kushtet ligjore për pamjaftueshmëri profesionale për shkak që me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar është cituar neni 10 i Rregullore për Transferimin e Nëpunësve Civil ndërsa në vendimin e kontestuar nuk i janë referuar Rregullores për Vlerësimin e Pamjaftueshmërisë Profesionale në Shërbimin Civil si rregullore e veçantë, pra nuk janë respektuar asnjë nga dispozitat e kësaj rregulloreje me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar. Tutje shton së vendimi i kontestuar ka konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet për transferim për shkak të pamjaftueshmërisë profesionale, pra, nëse i referohemi statistikave para transferimit të përkohshëm të ankueses që kishte ndodhur rezulton se nga muaji janar deri në muajin tetor 2024, janë trajtuar mijëra kërkesa dhe po thuajse 90% e planit është implementuar, kështu që nuk qendror fare konstatimi si në vendimin e kontestuar. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet akti i kontestuar dhe të obligohet Kryetari i Kryeqytetit që ankuesen të kthejë në vendimin e punës sipas aktit të emërimit.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës konstaton se e njëjta është e lejueshme në kuptim të nenit 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, dhe e njëjta është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa, kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit, iu referua:

I. Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë

-neni 54 përcakton se: *1. Pamjaftueshmëria profesionale nënkupton mungesën e plotë të aftësive të nëpunës/it civil për të përmbushur detyrat e punës të lidhura me pozitën e saj/tij, mungesën e përsëritur të saktësisë dhe përkushtimit, mungesën e përsëritur të përmirësimit profesional në realizimin e detyrave. 2. Inicimi dhe shqiptimi i masës për vlerësimin e pamjaftueshmërisë profesionale bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë me miratimin e zyrtarës/it kryesor administrativ. 3. Masat që mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për pamjaftueshmëri profesionale janë: 3.1. ndjekje e detyrueshme e trajnimit për përmirësim të aftësive profesionale; 3.2. transferimi në një pozitë tjetër; 3.3. inicim i procedurës në Komision Disiplinor. 4. Procedura e vlerësimit të pamjaftueshmërisë përcaktohet me akt nënligjor nga ministria përgjegjëse për administratë publike.*

II. Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë,

Neni 10 përcaktohen se: *1. Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit në një pozitë tjetër të shërbimit civil, në rast të: 1.1. paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme; 1.2. shmangies së një konflikti të vazhdueshëm interesi, të përcaktuar me ligj; 1.3. përfundimit të pezullimit, me kërkesë të nëpunësit kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës; 1.4. shqiptimit të transferimit si masë e pamjaftueshmërisë profesionale; 1.5. shqiptimit të transferimit si masë disiplinore. 2. Transferimi i përhershëm sipas nën paragrafëve 1.1. dhe 1.3. të paragrafit 1 të këtij neni është vendim i drejtuesit më të lartë administrativ dhe bëhet pas kërkesës së nëpunësit civil. 3. Transferimi i përhershëm*

sipas nën paragrafit 1.2. të këtij neni është vendim i drejtuesit më të lartë administrativ. 5 / 9 4. Transferimi i përhershëm sipas nënparagrafit 1.4. të paragrafit 1 të këtij neni, është vendim i drejtuesit më të lartë administrativ pas pëlqimit të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.

III.Rregullores (MPB) 02/2024 për Vlerësimin e Pamjaftueshmërisë Profesionale në Shërbimin Civil, përkatësisht:

-neni 4 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. Pamjaftueshmëria profesionale nënkupton: 1.1. mungesën e plotë të aftësive të nëpunësit civil për të përmbushur detyrat e punës të lidhura me pozitën e tij; 1.2. mungesën e përsëritur të saktësisë dhe përkushtimit; apo 1.3. mungesën e përsëritur të përmirësimit profesional në realizimin e detyrave. 2. Mbikëqyrësi duhet që para se të shqiptojë pamjaftueshmërinë profesionale, të takohet me nëpunësin dhe t'i ofrojë rekomandime për përmirësim brenda një periudhe të arsyeshme, por jo më gjatë se tre (3) muaj. Nëse nëpunësi nuk tregon përmirësim brenda kësaj periudhe, mbikëqyrësi mund të shqiptojë pamjaftueshmërinë profesionale.

- neni 5 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. Mungesa e plotë e aftësive për të përmbushur detyrat e punës nënkupton pamundësinë e nëpunësit civil për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tij. 2. Kjo mund të përfshijë: 2.1. mungesën e aftësive teknike dhe profesionale të nevojshme për detyrat specifike të punës; 2.2. mos përvetësimin e njohurive bazë dhe aftësive praktike për kryerjen e funksioneve të punës; 2.3. dështimin për të ndjekur udhëzimet dhe procedurat e punës, pavarësisht trajnimeve të përsëritura.

-neni 6 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. Mungesa e përsëritur e saktësisë dhe përkushtimit nënkupton kryerjen e detyrave të punës në mënyrë të vazhdueshme me gabime dhe pa përkushtimin e duhur profesional. 2. Kjo mund të përfshijë: 2.1. gabimet e përsëritura në realizimin e detyrave; 2.2. mos përmbushjen e standardeve të cilësisë të përcaktuara për detyrat e punës; 2.3. dështimin për të përfunduar detyrat brenda afateve të caktuara pa arsye.

-neni 7 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. Mungesa e përsëritur e përmirësimit profesional nënkupton dështimin e vazhdueshëm të nëpunësit civil për të përmirësuar aftësitë dhe njohuritë e tij profesionale, pavarësisht mundësive dhe trajnimeve të ofruara nga mbikëqyrësi dhe NjMBNj. 2. Kjo mund të përfshijë: 2.1. mos pjesëmarrja në trajnime dhe programe të zhvillimit profesional pasi i është bërë e njohur nevoja për mbajtjen e tyre nga mbikëqyrësi; 2.2.dështimi për të përvetësuar njohuritë dhe aftësitë e reja të kërkuara për përmbushjen e detyrave të punës; 2.3. mos aplikimi i njohurive të përfituara nga trajnime të mëparshme në detyrat e përditshme të punës.

-neni 8 paragrafi 1, 2 dhe 3, ku përcaktohet: 1. Inicimi dhe shqiptimi i masës për vlerësimin e pamjaftueshmërisë profesionale bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në SIMBNj. 2. Para shqiptimit të masës për vlerësimin e pamjaftueshmërisë profesionale masa duhet të aprovohet nga zyrtarit kryesor administrativ. 3. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë paraqet një raport të detajuar mbi arsyet e shqiptimit të pamjaftueshmërisë dhe shkaqet e pamundësisë së tij për të përmbushur detyrat e punës, duke ofruar edhe dëshmitë përkatëse.

-neni 9 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: 1. Masat që mund të shqiptohen ndaj nëpunësit civil për pamjaftueshmëri profesionale janë: 1.1. ndjekja e detyrueshme e trajnimit për përmirësim të aftësive profesionale që mund ti shqiptohet nëpunësit për rastet e përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje; 1.2. inicim i procedurës disiplinore në Komision Disiplinor që mund ti shqiptohet nëpunësit për rastet e përcaktuara në nenin 6 të kësaj Rregulloreje; 1.3. transferimi i përhershëm në një pozitë tjetër të shërbimit civil që mund ti shqiptohet nëpunësit për rastet e përcaktuara në nenin 7 të kësaj Rregulloreje. 2. Transferimi i përhershëm në një pozitë të kategorisë së njëjtë të shërbimit civil si masë e pamjaftueshmërisë profesionale, bëhet nga zyrtari kryesor administrativ pa pëlqimin e nëpunësit civil.

Në kuptim të kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji ka analizuar aktin e kontestuar dhe si rrjedhojë ka gjetur se masa e transferimit të ankueses si pasojë e pamjaftueshmërisë profesionale, është shqiptuar më arsyetimin se në kohën kur ankuesja ka qenë e transferuar në pozitë tjetër ishin proceduar 3000 kërkesa dhe ka ndikuar në performancën e drejtorisë, duke mos dhënë asnjë shpjegim krahasuese dhe pse ankuesja kishte tregu paaftësi profesionale, ndërsa, sipas raportit të dërguar nga ankuesja për periudhën janar-tetor të vitit 2024, rezulton se nga aktivitetet e Drejtorisë për Pronë dhe Kadastër në Komunën e Prishtinës, në kuadër të Sektorit të Gjeodezisë, janë pranuar 23174 kërkesa për certifikata të pronësisë dhe kopje të plani dhe janë aprovuar të gjitha, janë pranuar 1012 kërkesa për ndarje parcializimet copëtimet dhe janë aprovuar 940 sosh, janë pranuar 351 kërkesa për bashkim të parcelave, dhe janë aprovuar 321 sosh, janë pranuar 192 kërkesa për legalizim të objekteve dhe janë aprovuar 192 sosh, janë pranuar 215 kërkesa për identifikim të parcelave dhe njërive banesore dhe janë aprovuar 195 sosh, janë pranuar 133 kërkesa për përcaktimin e kufijve të parcelave dhe janë aprovuar 125 sosh, janë pranuar 49 kërkesa për ri-rregullimin e kufijve të parcelave dhe janë aprovuar 49 sosh, janë pranuar 59 kërkesa për ndërrim destinim të tokës-bujqësor dhe janë aprovuar 59 sosh, janë pranuar 192 kërkesa për regjistrimin e objekteve dhe njërive banesore dhe janë aprovuar 192 sosh, janë pranuar 20 kërkesa zyrtare nga institucionet-shërbimi i gjeodezisë dhe janë aprovuar 20 sosh, pra nga numri i përcaktuar si më lartë janë pranuar gjithsej 25397 kërkesa dhe janë aprovuar 25267 ndërsa në procedurë kanë mbutuar 130 sosh, raporte këto që nuk ka prova se janë kontestuar nga zyrtarët menaxhues të Komunës së Prishtinës.

Rrjedhimisht, Komuna e Prishtinës me rastin e dërgimit të përgjigjes në ankesë nuk ka ofruar prova materiale me të cilat dëshmohet se performanca e ankueses për kohën sa ka ushtruar pozitën Udhëheqëse e Sektorit të Gjeodezisë ka qenë më performancë të ulët, gjegjësisht nuk janë ofruar prova që argumentojnë faktin se ankuesja nuk ka përmbushur detyrat e punës. Për me tepër, nuk ka shkresa se ankuesja ka në fuqi ndonjë masë disiplinore për mos përmbushje të detyrave të punës, si shkelje e rëndë apo dëshmi tjetër që pohon faktin relevant së mbikëqyrësi i ankueses kishte shpreh pakënaqësi në raport me ankuesen në drejtim të mos përpushjes apo të paaftësisë në përmbushje të detyrave të punës. E në këtë kontekst, Kolegji nga administrimi i shkresave të lëndës nuk ka gjetur formularë lidhur me vlerësim e rezultateve në punë për ankuesen për vitet 2023, 2024 dhe 2025, si fakte relevante.

Kolegji po ashtu thekson faktin se sipas shkresave të lëndës ndaj ankueses në vitin 2025 është iniciuar procedurë disiplinore pranë Komisionit Disiplinor për shkak të mungesës në punë, mirëpo Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës përmes Vendimit me numër protokolli 14-020/04-71518/25 të datës 22.05.2025, ka refuzuar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses, ndërsa, më datë 01.04.2025, 02.04.2025, 14.04.2025 dhe 03.06.2025, Drejtori për Kadastër dhe Gjeodezisë ka shqiptuar vërejtje me shkrim për ankuesen për mos respektim të orarit të punës, por që këto masa nuk kanë të bëjnë me mos përmbushje të detyrave të punës.

Sipas Rregullores (MPB) 02/2024 për Vlerësimin e Pamjaftueshmërisë Profesionale në Shërbimin Civil, pamjaftueshmëria profesionale nënkupton: *mungesën e plotë të aftësive të nëpunësit civil për të përmbushur detyrat e punës të lidhura me pozitën e tij; mungesën e përsëritur të saktësisë dhe përkushtimit; apo mungesën e përsëritur të përmirësimit profesional në realizimin e detyrave*, e në rastin konkret edhe pse janë kërkuar prova sipas kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 29.06.2026, nëse ka pasur ndonjë raport nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses lidhur me shqiptimin e masës së pamjaftueshmërisë

profesionale dhe nëse ka pasur dëshmi se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është takuar me ankesën për të diskutuar çështjet kontestuese dhe nëse është ofruar ndonjë rekomandim për përmirësim, mirëpo, siç u tha më lartë e duke u bazuar në provat e lëndës të dërguar përmes përgjigjes në ankesë të datës 15.07.2026, nuk rezulton të këtë ndonjë procedurë të iniciuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses për shqiptimin e masës së pamjaftueshmërisë profesionale, pra nuk ka asnjë raport me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i cili do të pasqyronte në detaje arsyet e shqiptimit të pamjaftueshmërisë dhe shkaqet e pamundësisë së tij për të përmbushur detyrat e punës.

Andaj, nisur nga rrethanat dhe konstatimet si më sipër, Kolegji konstaton se organi që ka nxjerrë aktin e kontestuar nuk ka arrit të argumentoj dhe arsyetoj masën e transferimet të ankueses për shkak të paaftësisë profesionale dhe se duke qenë së kjo masë nuk është ndjek më zbatimin paraprak të hapave ligjore siç kërkohet më Rregulloren (MPB) 02/2024 për Vlerësimin e Pamjaftueshmërisë Profesionale në Shërbimin Civil, Kolegji vlerëson se Vendimi me numër protokolli 14-020/04-77518/26, i datës 29.05.2026, të Kryetarit të Kryeqytetit (Komunës së Prishtinës), konsiderohet akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr.05/-L-03.1 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Për sa më sipër, e duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.693/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat Fis Murati dhe Avokat Shkëlzen Feka;
- Organit të punësimit: Kryetarit dhe Njësisë për Burime Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;